



| | | | |
|--|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar Pritiljeno/Prodato Received/Delivry | 28.12.2022 | viti god year | |
| Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKM/SHK | 8560/2022 | | 113 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1020/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, duke vepruar sipas ankesës me numër A.nr.1020/2022 të datës 17.11.2022 të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit/Komuna e Vitisë, në çështjen juridike "Shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 28.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.2020/2022 e datës 17.11.2022 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja, e punësuar në Komunën e Vitisë, me datë 15.11.2022 përmes postës ka parashtruar ankesë e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është pranuar me datë 17.11.2022 me numër protokollit 7193/2022 dhe është regjistruar nën shenjen A.nr.1020/2022, kundër heshtjes administrative të institucionit punëdhënës lidhur me kërkesën e saj të datës 03.10.2022 për harmonizimin e koeficientit të pagës për pozitën e punës *Certifikues i Buxhetit*.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se njëjta është diskriminuar nga organi punëdhënës për faktin se sipas shkresës të datës 27.11.2014 të DASHC-së, për pozitën e punës *"Certifikues i Buxhetit"* koeficienti i pagës është nëntë (9) ndërsa e njëjta realizon pagën

me koeficient tetë (8), dhe si rrjedhojë kërkon t'i aprovohet ankesa dhe të detyrohet Komuna e Vitisë që të njëjtës t'ia ngrisë koeficientin nga tetë (8) në nëntë (9) duke ia kompensuar edhe pagesën e diferencës në pagë në vlerën e një koeficienti që nga data 27.11.2014.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurë e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 23.11.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Vitisë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll:7193/2022 të regjistruar me numër A.nr.1020/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e datës 17.11.2022; Kërkesën e ankueses me numër protokoll:06-320/04-41020 e datës 03.10.2022; Kërkesa e ankueses e datës 25.08.2022 e pa protokolluar; E-mailin e datës 30.08.2022 dërguar nga ankuesja për me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 25.08.2022 dërguar nga ankuesja për kërkesën e datës 24.08.2022 pa numër protokoll; Shkresën e DASHC/MAP-04/1571 e datës 27.11.2022; Akt emërimit e ankueses të datës 19.08.2014; Zarin postar me shifër R2561183; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 23.11.2022

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga pala në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e palejuar , *sepse:*

Kolegji për Shqyrtimi dhe Vendosjen e Ankesave, nga administrimi i shkresave të lëndës të parashtruara nga pala në procedurë ka gjetur se ankuesja sipas Aktit të Emërimit të datës 19.08.2019 është e punësuar në Komunën e Vitisë në pozitën e punës "Certifikuese e Buxhetit".

Sipas shkresave të lëndës rrjedh se ankuesja me datë 03.10.2022 ka parashtruar kërkesën me numër protokoll 06-320/04-41020 në Komunën e Vitisë, për harmonizimin e koeficientit të pagës nga koeficienti tetë (8), në koeficientin e pagës nëntë (9), si dhe pagesën e diferencës në pagë në mënyrë retroaktive. Rrjedhimisht, ankuesja me datë 15.11.2022 (e pranuar me datë 17.11.2022) ka parashtruar ankesë me bazë të njëjtë juridike në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës analizoi dispozitat Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenin 98 paragrafin 1 dhe 2, ku përcaktohet se: 1. *Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure.* 2. *Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj",* si dhe nenin 127 paragrafi 1 dhe 4 i të njëjtët ligj ku përcaktohet se: "1. *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.* 4. *Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.*

Referuar dispozitave të lartcekura ligjore dhe duke u bazuar në shkresat e administruara të lëndës është konstatuar se ankesa e ankueses e parashtruar me datë 15.11.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është e paraafatshme, ngase ankuesja me datë 03.10.2022 kishte parashtruar kërkesë me numër protokolli 06-320/04-41020 të organi punëdhënës, dhe si rrjedhojë pa kaluar afati për përfundimin e procedimit administrativ në kuptim të nenit 98 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e njëjta ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankueses e parashtruar me datë 15.11.2022 është parashtruar në kundërshtim me nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe si e tillë nuk e plotëson kushtin e nevojshëm të pranueshmërisë së ankesës në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBYMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1020/2022

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Jeton KOÇA

Kryetari i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Vitisë;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Vitisë;
- Arkivit të KPMSHCK-së.